



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.984/22

**GJYKATA KOMERCIALE** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NPSHT “F...” me seli në fshatin ..., Komuna e Rahovecit, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.770/18, të datës 03.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.04.2023, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, e dt.21.05.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.770/18, të datës 03.03.2021, **Vërtetohet**.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, nën pikën I të dispozitivit ka vendosur Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NPSHT “F...” me seli në fshatin ..., Komuna e Rahovecit. Në pikën II. Anulohet vendimi nr.59/2009 i datës 02.04.2009 i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë. Në pikën III. Obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, që paditësin NPSHT “F...” me seli në fshatin ....., Komuna e Rahovecit, ta liroj në tërësi nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit shtesë për të gjitha llojet e tatimit shtesë të rezultuar nga rritja e qarkullimit shtesë në vlerë prej 189,445.41€ (për periudhën 12/2006 në vlerë prej 72,018.55€ dhe periudhën 12/2007 në vlerë prej 117,426.86€, si dhe nga mos pranimi i shpenzimeve të interesit në vlerë të përgjithshme prej 311,834.42€ për vitet 2005-2007, sipas Njoftim Rivlerësimeve të Administratës Tatimore-Njësia e Tatimpagueseve të Mëdhenjë, të përpiluar bazuar në Raportin e Kontrollit të ATK-së së datës 23.12.2008. Në pikën IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në këtë konflikt administrativ.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura ka ushtruar ankesë me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të; shkeljes së dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë të merr aktgjykim me të cilin aprovohet ankesa e të paditurës ATK, si e bazuar, anulohet aktgjykimi A.nr.770/18 i datës 03.03.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, të mbetet në fuqi vendimi me nr. 59/2009 i datës 02.04.2009 i Administratës Tatimore të Kosovës ose të merr aktvendim me të cilin aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, të prishet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ-Divizioni Fiskal A.nr. 770/18 i datës 03.03.2021 dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPKsë, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

**Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se, e paditura me vendimin nr.59/2009 i datës 02.04.2009, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar ankesën e tatimpaguesit NPSHT "F..." me NRB: ..., me pronar N.F. nga fsh. ....-KK-Rahovec, si e pa bazë kundër vendimit mbi Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të Administratës Tatimore-Njësia e Tatimpaguesëve të Mëdhenj. Në pikën II. Procedura e ankesës nuk ndërprente sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi, sipas Ligjit nr.2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

I pakënaqur me vendimin e ATK-së, paditësi ushtron padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në procedurë të konfliktit administrativ. Gjykata e shkallës së parë, në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81G të Ligjit nr. 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222 dhe në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.nr. 305/2013 të datës 14.03.2018 në seancën e mbajtur me datë 03.03.2021 vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në drejtim të thenieve në padi, deklarimeve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në konflikt administrativ, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, e anulon vendimin nr.59/2009 i datës 02.04.2009 të Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, sipas konkludimeve ndër të tjera në arsyetim se; Gjykata konstaton se në vendimin e kontestuar të Departamentit të Ankesave të ATK-së me nr. 59/2009 të datës 02.04.2009, por edhe në Raportin e Kontrollit të datës 23.12.2008, nuk janë konstatuar pa rregullsi në mbajtjen e regjistrimeve dhe librave nga

ana e paditësit apo shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, respektivisht nenit 12 të Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe nenin 9.14 të rregullores nr. 2004/52 Mbi Tatimin në të Ardhurat Personale. Në këtë aspekt Gjykata ka vlerësuar se e paditura nuk ka konstatuar dhe nuk ka provuar me asnjë pa rregullësi nga evidencat materiale-financiare të Raportit të blerje-shitje-stoqe për paditësin. Nuk janë provuar pa rregullsi në kuptim të asaj se nuk janë lëshuar fatura-kuponët e shitjes për konsumatorë-blerës ose që këto shitje nuk janë regjistruar në librin e shitjes dhe nuk janë dekluar në ATK. Për të vërtetuar rrethanat nëse paditësi i ka mbajtur librat dhe regjistrimet e biznesit sipas legjislacionit tatimor, respektivisht nëse i njejtë ka pasur parregullësi në mbajtjen e këtyre regjistrimeve për periudhën e kontrollit nga ATK, për të nxjerr konstatimin nëse e paditura ka aplikuar drejtë marzhën tregtare prej 9.54% për shitjet e tatimpaguesit, pastaj për të konstatuar nëse shpenzimet e interes të deklaruar nga paditësi i kanë përmbushur kriteret ligjore për tu njohur si shpenzime të zbritshme për qëllime tatimore, si dhe për të nxjerr konstatimin nëse e paditura ka vepruar drejt kur i ka rritur çmimet e shitjes të deklaruara të paditësit, gjykata me propozimin e të autorizuarit të paditësit në seancën e datës 21.10.2020 në rigjykim ka caktuar ekspertizën financiare në këtë konflikt administrativ. Nga vlerësimet dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar në ekspertizën e datës 10.12.2020 dhe të paraqitura edhe në shqyrtimin kryesor publik të datës 03.03.2021 nga ana e ekspertit financiar Sh.B., për vëllimin dhe lëndën e ekspertizës është dhënë mendimi dhe konstatimi profesional sipas të cilit paditësi ka mbajtur evidencat e të gjitha regjistrimeve të nevojshme dhe librat e duhura sipas legjislacionit tatimor dhe standardeve të kontabilitetit, konform nenit 12 të Ligjit nr. 2004/48 si dhe ka deklaruar dhe paguar brenda afateve ligjore të gjitha llojet e detyrimeve tatimore. Në lidhje me marzhën e aplikuar nga e paditura prej 9,54% për shitjet e paditësit, eksperti ka dhënë mendimin se në këtë rast nuk është vepruar drejt nga e paditura, sepse marzha e llogaritur nga paditësi duke marrë për bazë stoqet, blerjet, KMSH-në, fitimin bruto dhe të hyrat nga shitja janë të sakta dhe të deklaruara sipas viteve 2005-2007. Sa i përket shpenzimeve të interesit të cilat nuk janë pranuar nga e paditura, eksperti financiar ka konstatuar se shpenzimet e interesit të deklaruar nga paditësi i kanë përmbushur kriteret ligjore për tu njohur si shpenzime të zbritshme për qëllime tatimore, kjo për arsye se Ndërmarrja e privatizuar IMN “T...” ka pasur aktivitet afarist dhe se referuar Standardeve Kosovare të Kontabilitetit SKK9, *“Kostoja e huazimit duhet të pranohet si një shpenzim gjatë periudhës kur është krijuar ajo”*. Gjykata mori në tërësi si të bazuar dhe ia dha besimin e plotë ekspertizës së lartpërmendur, ngase ekspertiza i përmbante elementet e nevojshmetë dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoj si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë konflikt administrativ, si dhe për faktin se e njëjta ishte në harmoni edhe me legjislacionin tatimor të aplikueshëm. Gjykata ka konstatuar se e paditura nuk ka vepruar drejtë dhe në harmoni me ligjin kur paditësin e ka ngarkuar me qarkullim shtesë, si rezultat i rritjes së marzhës së deklaruar nga paditësi, në disa artikuj për çmimet me pakicë, duke eliminuar pa bazë artikuj tjerë, sepse një vlerësim i tillë sipas gjykatës nuk ka bazë ligjore dhe faktike në shkresat e lëndës. Gjithashtu gjykata vlerëson se e paditura nuk ka vepruar drejtë kur paditësin nuk i ka

pranuar shpenzimet e kamatave-interesit të ndodhura në vitin 2005 në vlerë prej 27,073.97€ për vitin 2006 në vlerë prej 156,284.30€ dhe për vitin 2007 në vlerë prej 128,376.15€, në total shpenzime e interesit në shumë prej 311,834.42€ nga kredia e paditësit e marr për qëllime të investimeve kapitale, respektivisht për blerjen e ndërmarrjes së privatizuar “T...”, për arsye se këto shpenzime kanë ndodhur për qëllime të investimeve kapitale, pra për aktivitet ekonomik dhe ky fakt nuk është konstatuar as nga e paditura në vendimin e kontestuar, andaj sit ë tilla këto shpenzime i kanë përmbushur të gjitha kushtet ligjore që të njihen si të zbritshme për qëllime tatimore, për periudhat tatimore respektive, sipas nenit 9.3 pika e) të Rregullores nr. 2004/52 mbi Tatimin në të Ardhuara Personale, dhe Standardit Kosovar të Kontabilitetit me nr. SKK9, pika 5.

Dhoma e Shkallës së Dytë duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, i pranon në tërësi si të drejta dhe ligjore konkludimet juridike të gjykatës së shkallës së parë, sa i përket gjendjes faktike të çështjes, e gjithashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i ekzaminon sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe 194 të LPK. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar si në vështrim të nenit 81G të Ligjit nr. 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi raportit të kontrollit, si dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është e bazuar, duke e anuluar vendimin e organit të paditur nr.59/2009 i datës 02.04.2009 të Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, dhe e obligon të paditurën ATK, që paditësin ta liroj në tërësi nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit shtesë për të gjitha llojet e tatimit shtesë të rezultuar nga rritja e qarkullimit shtesë në vlerë prej 189,445.41€ (për periudhën 12/2006 në vlerë prej 72,018.55€ dhe periudhën 12/2007 në vlerë prej 117,426.86€, si dhe nga mos pranimi i shpenzimeve të interesit në vlerë të përgjithshme prej 311,834.42€ për vitet 2005-2007, sipas Njoftim Rivlerësimeve të Administratës Tatimore-Njësia e Tatimpagueseve të Mëdhenje, të përpiluar bazuar në Raportin e Kontrollit të ATK-së së datës 23.12.2008.

Pretendimet ankimore të paditurës nga bazat ankimore të theksuara si më lartë si dhe pretendimet e tjera si në arsyetim të ankesës, kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, sepse nuk janë të bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara, andaj kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, përgjigjen në padi pastaj ka caktuar seancë të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme e që kuptohet se gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së. Nuk qëndrojnë pretendimet e te paditurës te cekura ne ankesë se aktgjykimi i atakuar i gjykatës se shkalles se parë është përfshi ne shkelje te dispozitave te procedurës administrative pasi është anuluar vendimin nr. 59/2009 te

Departamentit te ankesave ndërsa nuk ka anuluar njoftim vlersimn e dal nga raporti i kontrollit i dt. 23.12.2008 për arsye se, gjykata si rregull anulon vetëm vendimin i cili është definitiv ne procedure administrative, e ne rastin konkret vendimin e Departamentit ankesave te ATK, pasi ky vendim kontestues ka konfirmuar njoftim rivlerësimin e raport kontrollit, ndërsa me anulimin e vendimit kontestues kuptohet se është anuluar edhe njoftim vlerësimi me te cilin është caktuar tatim shtese për tatimpaguesin-paditësin.

Gjendja faktike në këtë konflikt administrativ është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës, për arsye se, gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sipas kolegjit të kësaj gjykate gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizës financiare, si prova të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, i pranon si të tilla edhe Kolegji, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË**

**Dhoma e Shkallës së Dytë**

**Kom.Dh.Sh.II.nr.984/2022 me datë 05.04.2023**

**Kryetari i Kolegjit, gjyqtari  
Ramush Bardiqi**